

KAPITULLI I TRETË

**E BRENDSHMJA
PASUROHET
PËRMES VUAJTJEVE
DHE VËSHTIRËSIVE**

“Ju jeni mësuesi im shpirtëror”



Pasi kaluam lumin Imxhin, kaluam nëpër Seul, Uongxhu dhe Kjungxhu, deri në Busan. Atje arritëm, përfundimisht, më 27 janar 1951. Busani ishte mbushur me refugjatë nga veriu. Dukej sikur i gjithë vendi ishte mbledhur atje. Çdo vend ku mund të rrije ishte i zënë tashmë. Vendi i vogël, ku rrinim ne, mezi kishte hapësirë për t'u ulur. E vetmja zgjidhje tjetër ishte të shkonim natën në pyll, të ngroheshim si të mundnim dhe, pastaj, të ktheheshim ditën në qytet për të kërkuar ushqim.

Flokët, që i kisha mbajtur të shkurtra në burg, më ishin rritur përsëri. Pantallonat, që i kisha arnuar nga brenda me pjesë pambuku të marra nga një jorgan, ishin grirë fare. Rrobat ishin te ngopura aq shumë me zgjyrë yndyre, sa pikat e shiut të fortë nuk përthitheshin, por më tepër rrëshqisnin dhe rrokulliseshin mbi të.

Nga shojet e këpucëve nuk kishte mbetur pothuajse asgjë, megjithëse pjesa e sipërme ishte akoma në vend. Mund të kisha ecur edhe zbathur. Ishte fakt që, thjesht, isha më i ulëti ndër të ulët, një lypës mes lypësish. Nuk kishte ku të punoje, dhe ne nuk kishim asnjë dyshkë në xhep. E vetmja mënyrë për t'u ushqyer ishte të lypje.

Megjithatë, edhe kur isha duke lypur për ushqim, unë mbaja dinjitetin. Nëse dikush refuzonte të ndihmonte, i thosha me një zë të qartë dhe të sigurt: “Dëgjo, nëse nuk ndihmon njerëz si ne, që kanë nevojë, ti do të

kesh vështirësi të mëdha, nëse shpreson të marrësh bekim në të ardhmen!”. Kur dëgjonin këto fjalë, njerëzit jepnin. E merrnim ushqimin që mblidhnim në këtë mënyrë dhe e çonim në një vend të sheshtë, ku mund të uleshim së bashku. Kishte me dhjetëra njerëz që hanin në vende të tilla. Nuk kishim asgjë, madje, edhe për ushqim duhet të lypnin, por midis nesh ekzistonte vazhdimisht një miqësi e ngrohtë.

Njëherë, në mes të një dite të atillë, befas dëgjova dikë që thërriti: “Pa shiko, pa shiko! Sa kohë ka kaluar?”

U ktheva dhe pushë përballë meje të qëndronte Duk Mun Um, një shok i kohës së Japonisë. Duk Mun Um më kishte bërë shok jete atëherë, kur u prek shumë nga kënga patriotike që këndova. Sot ai është një nga arkitektët më të shquar të Koresë, që ka bërë projektin e qendrës kulturore “Sexhong” dhe hotelin “Lote”.

“Shkojmë,- më tha ndërsa më përqafoje, ashtu të rreckosur. - Shkojmë te shtëpia ime”.

Në atë kohë, Duk Mun Um ishte i martuar. Jetonte me familjen e tij në një dhomë të vetme. Që të bënte vend për mua, ai vari një jorgan në mes të dhomës, duke ndarë një pjesë të dhomës për mua. Në anën tjetër flinte ai, me gruan dhe dy fëmijët e tij të vegjël.

“Tani,- më tha, më trego për jetën tënde kohët e fundit. Kam pyetur veten gjithmonë ku do të ishe dhe çfarë do të ishe duke bërë. Kemi qenë shokë të ngushtë”,- më tha, - por ti gjithmonë ke qenë më shumë se shok për mua. A e di që kam pasur gjithmonë një respekt të thellë për ty?”

Deri në atë moment, nuk e kisha hapur zemrën me asnjë nga shokët e mi. Në Japoni, shkova deri aty sa fshihja edhe faktin që lexoja shpesh biblën. Nëse hynte dikush në dhomë, kur isha duke e lexuar atë, unë e fshihja me shpejtësi. Por në shtëpinë e Duk Mun Um, e tregova për herë të parë historinë time. Fola gjithë natën. I tregova për takimin tim me

Zotin, kalimin e paralelit 38°, themelimin e një kishe dhe mbijetesën në burgun Hëngnamit. Mu deshën plot tri ditë për ta mbaruar së treguari historinë time. Kur mbarova, Duk Mun Um u ngrit dhe u përkul me gjuhë para meje, në një përkulje të plotë ceremoniale.

“Çfarë bën?”, - e pyeta i tronditur dhe i habitur. I kapa dorën dhe u përpoqa ta ndaloja, por ishte e kotë. Nuk e bëra dot.

“Që nga ky çast,- tha Duk Mun Um, - ti je mësuesi im i madh shpirtëror. Kjo përkulje është përshëndetja ime ndaj teje si mësuesi im, prandaj të lutem pranoje”.

Që atëherë ai ka qëndruar me mua, si shok dhe si dishepull në të njëjtën kohë.

Menjëherë pas kësaj, gjeta punë në molin Pier 4, në portin e Busanit. Punoja vetëm natën. Me rrogën time blija pure fasuleje në stacionin Çoriang. Pureja e nxehtë shitej me një copë që mbështillte enën, që ta mbante atë të ngrohtë. Gjithmonë e mbaja tasin e puresë pas trupit për më shumë se një orë, para se ta haja. Kjo më ndihmonte të ngrohesh, pasi kisha punuar gjithë natën e gjatë dhe të ftohtë.

Gjeta vend për të fjetur në një strehë për punëtorët, në lagjen Çoriang. Dhoma ime ishte aq e vogël, sa nuk i shtrija dot këmbët, madje, as diagonalisht, pa i ngjeshur këmbët për muri. Por kjo ishte dhoma ku mpreha një laps dhe, me solemnitet, shkrova bocën e parë të “Uoli Uonbon” (varianti fillestar i “Parimit Hyjnor”). Financiarisht isha në skamje, por kjo nuk kishte rëndësi. Edhe sikur të jetoja në një grumbull plehrash, nuk ka asgjë që s’ë bën dot një shpirt i vendosur. Gjithë ç’na duhet është vullneti.

Uon Pil Kimi sapo kishte mbushur njëzet vjeç. Ai bënte lloj-lloj punësh. Punonte në një restorant dhe sillte në shtëpi orizin e përcëlluar, që nuk mund t’u shërbehej klientëve. E hanim atë së bashku. Duke pasur talent në pikturë, shpejt ai zuri punë në ushtrinë e Shteteve të Bashkuara, si piktor.

Më në fund ai dhe unë u ngjitëm në Bomnetgol, në Bom-il Dong dhe ndërnuam një shtëpi. Ngaqë ishte afër varrezave, ky vend nuk kishte asgjë tjetër pranë, përveç një gryke shkëmbore. Nuk kishim një tokë që mund ta quanim tonën, kështu që sheshuam një pjesë të atij shpati të pjerrët dhe ndërnuam një shtëpi. Nuk kishim as lopatë! Morëm një lopatë të vogël në kuzhinën e dikujt dhe ia çuam në vend, para se i zoti ta merrte vesh që i mungonte. Uon Pil Kimi dhe unë thyem gurë, gërmuam tokën dhe transportuam zhavorr. Përziemë baltën me kashtë, bëmë qerpiçë dhe i vumë njëra mbi tjetrën për të bërë muret. Morëm disa kuti kartoni, bosh, nga baza amerikane, i hapëm dhe i përdorëm si çati. Në vend të dyshemesë shtruam një copë plastmasë të zezë.

Edhe kasollet më të thjeshta ndërtoheshin më mirë se ajo. Kasollja jonë ishte e mbështetur pas një mase të madhe guri, kështu që një goxha pjesë shkëmbi dite në mes të dhomës. Pasuria jonë e vetme ishin tavolina e vogël, që mbahej pas shkëmbit, dhe këmbaleci i pikturave të Uon Pil Kimit. Kur binte shi, një rrëke shkonte përmes dhomës. Sa romantike ishte kur dëgjoje zhurmën e ujit që gurgullonte pranë vendit ku rrinim ulur! Në mëngjes, pasi kishim fjetur në këtë dhomë pa ngrohje, me çatinë që pikonte dhe ujin që rridhte pranë nesh, ngriheshim nga gjumi me hundët plot. Edhe pse në këto kushte ne përsëri ishim të lumtur për atë vend të vogël, ku kishim mundësi të shtriheshim dhe të qetësonim mendjen. Rrethanat ishin të mjerueshme, por ne ishim plot me shpresë, ngaqë jetonim në udhën e vullnetit të Zotit.

Çdo mëngjes, kur Uon Pil Kimi shkonte në punë në bazën amerikane, e shoqëroja deri në rrëzë të kodrës. Kur kthehej në shtëpi, në mbrëmje, unë dilja për ta mirëpritur. Pjesën tjetër të kohës e shpenzoja për të shkruar “Uoli Uonbon-in”. Dhoma jonë ishte plot me lapsa të mprehur. Edhe kur nuk kishim oriz në tenxhere, lapsa kishim.

Uon Pil Kimi më ndihmonte në shumë mënyra, si materialisht ashtu edhe shpirtërisht. Kështu qeshë në gjendje të përqendrohem në të shkruar. Madje, edhe kur ishte i rraskapitur nga puna e një dite të tërë, më ndiqte nga pas duke u munduar të më ndihmonte. Ato kohë flija aq pak, saqë mund të më zinte gjumi kudo. Nganjëherë më zinte gjumi edhe në nevojto. Uon Pil Kimi më ndiqte deri në nevojto për t'u siguruar që isha mirë.

Por kjo nuk ishte e gjitha. Ai kishte kaq shumë dëshirë të kontribuonte, sikur edhe fare pak, në librin që po shkruaja. Filloi të pikturojë portrete për ushtarët amerikanë, dhe kështu nxirrte para për të më furnizuar me lapsa. Në atë kohë, ishte e modës midis ushtarëve amerikanë të kishin një portret të pikturuar me gruan apo me të dashurën, para se të ktheheshin në Amerikë. Uon Pil Kimi ngjiste copa mëndafshi mbi kornizat e drunjta, pikturonte portretet dhe i shiste katër dollarë secilin.

Ndihesha mirënjohës për përkushtimin që ai kishte. Ulesha pranë tij kur pikturonte dhe bëja ç'të mundja për ta ndihmuar. Kur ishte në punë, atje te baza amerikane, vija ngjitësin në mëndafsh, prisja dërrasat për korniza dhe i ngjisja. Para se të vinte në shtëpi, unë i laja furçat dhe i blija bojërat që i nevojiteshin. Pasi vinte në shtëpi, ai merrte një laps të tipit 4B dhe vizatonte një portret. Në fillim bënte vetëm një apo dy, por shpejt u hap fjala për punën e tij. Ai u bë kaq i njohur ndër ushtarët, sa filloi të bënte deri njëzet-tridhjetë piktura njëherësh. Arriti deri atje sa shtëpia u mbush plot me portrete, dhe ne nuk gjenim dot vend ku të flinim.

Me rritjen e ngarkesës së punës, fillova ta ndihmoj më shumë. Uon Pili vizatonte skicën e fytyrave, ndërsa unë ngjyrosja buzët dhe rrobat. Nga paratë që fitonim bashkë, blinim lapsa dhe materiale për pikturë, dhe pjesën tjetër e shpenzonim për të dëshmuar. Është e rëndësishme t'i regjistrosim fjalët e Zotit, me shkrim, por akoma më e rëndësishme është t'u tregosh atyre për vullnetin e Tij.

Burri i pashëm, i çmendur pranë burimit



Kur ndërtuam shtëpinë me mure balte dhe themeluam kishën në Bomnetgol, ishin vetëm tre veta që më dëgjonin kur predikoja. Sidoqoftë, sipas meje, unë nuk isha duke u folur vetëm atyre tre vetëve. Thosha me vete: “Megjithëse nuk është e mundur të shihen, jam duke u predikuar një mijë, madje mijëra vetëve”. Ndërkohë që predikoja, imagjinoja sikur i gjithë njerëzimi më dëgjonte. Këta të tre uleshin para meje ndërsa unë iu transmetoja fjalët e Parimit me një zë të lartë dhe kumbues.

Përpara shtëpisë sonë ishte një burim. Shpejt filloi të përhapet një thashethem, midis atyre që vinin të mbushnin ujë në atë burim, sikur në shtëpinë me mure prej balte jetonte një burrë i çmendur. Ata merrnin me marifet ujë dhe ia ngulnin sytë asaj karakterit prej balte për të parë burrin e leckosur, që fliste sikur po i jepte urdhra gjithë botës. Ishte më se e natyrshme që njerëzit filluan të flasin me njëri-tjetrin. Unë predikoja që qielli dhe toka të ktheheshin përmbys dhe se Koreja do të bashkonte botën.

Thashethemet rreth meje u përhapën nga ata që mbushnin ujë në burim, deri tek ata që jetonin në rrëzë të kodrës. Ndoshta, ato thashetheme i bënë njerëzit të vinin tek ne, nga kurioziteti për të parë burrin e çmendur që jetonte pranë burimit.

Midis kureshtarëve kishte dhe studentë nga një seminar teologjik aty pranë, si dhe një grup profesorësh nga Universiteti prestigjioz i vajzave “Euha”. Thashethemet i zbukuronin, kur thoshin se isha një burrë i pashëm dhe shtathedhur, kështu që gra në moshë të mesme filluan t’i ngjiteshin kodrës për të më parë, si një mënyrë për të kaluar kohën.

Ditën kur mbarova së shkruari “Uolli Uonbon-in”, e lashë lapsin dhe u luta: “Ka ardhur çasti të ungjillëzoj. Të lutem, më dërgo shenjtorët të cilëve mund t’u dëshmoj”. Pas kësaj, dola për te burimi. Ishte 10 maj, fundi i pranverës. Kisha veshur pantallona tradicionale koreane prej pambuku, dhe një xhakëtë të vjetër, dhe isha djersitur nga vapa. Më zuri syri një grua që po fshinte djersën nga balli, ndërsa mundahej të ngjitej në kodër drejt burimit.

I fola duke i thënë: “Zoti të ka dhënë një dashuri të pamatshme gjatë këtyre shtatë viteve të fundit”. Ajo u zbraps nga habia. Ishin bërë shtatë vjet që kur ajo kishte vendosur t’ia kushtonte jetën Zotit.

“Quhem Hjun Shil Kang,- tha ajo.- Jam një ungjillore nga kisha e Bom Çonit, që ndodhet në lagjen rrëzë kodrës. Dëgjova se jeton një burrë i çmendur këtu, prandaj kam ardhur ta dëshmoj”.

Kjo ishte mënyra si më përshëndeti. E ftova të hynte brenda. Ajo pa rreth e qark dhomës së shkretë, duke e treguar hapur se sa e çuditshme i dukej. Në fund, sytë i shkuan te tavolina ime: “Pse ke kaq shumë lapsa?”, pyeti ajo.

“Deri sot në mëngjes,- iu përgjigja,- kam qenë duke shkruar një libër që zbulon parimet e universit. Mendoj se Zoti të ka dërguar këtu që të mësosh këto parime prej meje”.

“Çfarë thua?, - m’u kthye ajo. “Unë kam ardhur sepse dëgjova që jeton këtu një burrë i çmendur, i cili ka nevojë të dëshmohet”.

I zgjata një jastëk për t’u ulur dhe u ula edhe unë. Uji i burimit vazh-

donte të bënte atë zhurmën e vet, ndërsa rridhte pranë nesh.

“Në të ardhmen, Koreja do të luajë një rol të rëndësishëm në kulmin e botës” - i thashë. “Njerëzit do të pendohen që nuk do të kenë pasur mundësi të lindin në Kore”. Ajo mendonte me siguri që po flisja budalallëqe.

“Ashtu sikurse Elija u shfaq në personin e Gjon Pagëzorit, - vazhdova, - edhe Jezusi do të vijë si njeri me mish e me kocka në Kore”.

Kjo e nevríkosi atë.

“Jam e sigurt që Jezusi do të gjejë një vend më të mirë për të ardhur, sesa në një vend fatkeq siç është Koreja”, mu përgjigj.

Pastaj tha: “A e ke lexuar ndonjëherë Librin e Zbulesës? Unë e kam...”.

Ia lashë fjalinë përgjysmë, duke i thënë: “Ti do të thuash se ke studiuar në Seminarin Teologjik Gorio?”.

“Nga e di ti këtë?”, më pyeti ajo

“Ti mendon se mund të kisha pritur që ti të vije pa ditur as kaq gjë rreth teje? Ti the që ke ardhur për të më dëshmuar. Atëherë, të lutem, më mëso”.

Hjun Shil Kang ishte mjaft e ditur në teologji. Ajo më citoi vargje të Biblës, një nga një, duke u përpjekur të sulmonte pikëpamjet e mia. Ajo vazhdonte të më sfidonte me këmbëngulje, ndërsa unë i përgjigjesha të gjitha ndaj sfidave të saj me një zë të fortë dhe të qartë. Debatu ynë shkoi aq gjatë, sa filloi të errej, kështu që u ngrita dhe bëra darkën. E vetmja gjë që kishim, veç orizit, ishte pak kimçi i ndenjtur (kimçi është lakër e fermentuar me specë të kuq djegës ose me përbërës të tjerë që përdoren zakonisht në kuzhinën koreane). Gjithsesi, u ulëm nën zhurmën e ujit që rridhte poshtë nesh dhe e hëngrëm atë ushqim para se të rifillonim debatin.

Ajo erdhi përsëri të nesërmen, dhe të pasnesërmen; çdo herë për të

vazhduar debatin tonë. Në fund ajo zgjodhi t'ia dedikonte jetën e vet parimit që i mësova unë.

Më vonë, atë vit, një ditë nëntori me erë, u shfaq te dera e kasolles në Bomnetgol gruaja ime. Bashkë me të ishte edhe një djalë shtatë-vjeçar, im bir, që kishte lindur vitin kur unë u largova nga shtëpia. Atë ditë isha nisur thjesht për të marrë oriz por, në vend që të kthehesha, shkova në Penian. Vitet kishin kaluar dhe, tani, ai ishte rritur dhe ishte bërë djalë. Nuk guxova ta shikoja dot në sy, dhe as nuk munda të afrohesha dhe t'i prekja fytyrën e ta përqafoja me gëzim. Thjesht qëndrova aty si një statujë guri, i ngrirë në një vend, si memec.

Gruaja ime nuk ishte nevoja të thoshte asnjë fjalë. E ndjeva dhembjen dhe vuajtjen që iu desh të përjetonin kjo nënë e mjerë dhe ky fëmijë në kohën e luftës. Madje, para kësaj vizite, unë e dija ku jetonin dhe në çfarë kushtesh, por nuk kisha arritur ende në pikën që të isha në gjendje të kujdesesha për familjen time. Unë e dija këtë, prandaj i kërkova disa herë para se të martoheshim: “Të lutem, më beso dhe duro edhe pak”.

Kur të vinte koha e duhur, kisha planifikuar t'i merrja që të dy. Por në këtë situatë, ndërsa qëndronin tek porta, ajo kohë e duhur nuk kishte ardhur ende. Kasollja, kisha jonë ishte e vogël dhe e mjerë. Disa anëtarë hanin dhe jetonin atje, me mua, për të studiuar fjalën e Zotit. Unë nuk mund ta merrja familjen atje.

Gruaja i hodhi një vështrim rreth e qark kasolles, shprehu një zhgënjim të madh dhe u nis të ikte. Ajo, bashkë me tim bir, ikën duke zbritur tatëpjetën.

Një kishë pa përkatësi



Koreanët kanë një shprehje që thotë se: personi që ofendohet nga të tjerët jeton gjatë. Nëse do të jetoja në përpjesëtim të drejtë me numrin e fyerjeve që kam marrë, mund të jetoja edhe njëqind vite të tjera. Gjithashtu, stomaku im ka qenë i mbushur jo me ushqim, por me fyerje. Pra, mund të thuhet se stomaku im është më plot se i kujtdo tjetër. Ata nga kishat zyrtare që më kishin kundërshtuar dhe më kishin qëlluar me gurë, kur ngrita kishën në Penian, rifilluan përndjekjen ndaj meje; këtë radhë në Busan. Madje, para se të hapnim tamam kishën ata filluan të na shkaktonin telashe. Fjalët “heretik” dhe “pseudo” viheshin kaq shpesh para emrit tim, sa dukej se po bëheshin pjesë e tij. Në fakt, emri San Mjang Mun arriti të bëhet sinonimi i herezisë dhe pseudobesimit. Është e vështirë ta dëgjosh emrin tim të shqiptohet pa u shoqëruar nga ato fjalë.

Në vitin 1953 persekutimi arriti kulmin. Ne e mbyllëm kishën në Busan dhe shkuam, në fillim në Daegu, dhe pastaj në Seul. Në majin e vitit tjetër në morëm një shtëpi me qira në lagjen Bukhak Dong të Seulit, që ndodhej pranë Parkut Xhang-çong-dang, dhe varëm një tabelë ku shkruhej: “Shoqata e Shpirtit të Shenjtë për Unifikimin e Krishtërit Botëror”.

E zgjodhëm këtë emër për të thënë se nuk i përkisnim asnjë degëzimi, dhe, e sigurt, që nuk kishim ndonjë plan për të krijuar një të

tillë. Krishterimi botëror nënkupton krishterimin anëmbanë botës; si të shkuarin, ashtu edhe të tanishmin. Unifikimi zbulon qëllimin tonë për njësim dhe Shpirti i Shenjtë përdoret për të paraqitur harmoninë midis botës shpirtërore dhe botës fizike të ndërtuar përqendruar tek marrëdhënien e dashurisë at e bir. Me emrin e kishës ne donim të shprehim se “Bota shpirtërore, e përqendruar te Zoti, është me ne”.

Në veçanti, unifikimi përfaqëson qëllimin tim për të sjellë botën ideale të Zotit. Unifikimi nuk është bashkim. Bashkimi ndodh kur dy gjëra rrinë së bashku. Unifikimi është atëherë kur dy bëhen një. “Kisha e Unifikimit” u bë më vonë emri ynë i zakonshëm, por ai na është vënë nga të tjerët. Në fillim, studentët e universitetit na quanin “Kisha e Seulit”.

Mua nuk më pëlqen të përdor fjalën *kjohe* në përdorimin e saj të zakonshëm, që do të thotë kishë. Por, më pëlqen domethënia fillestare që ka në gjuhën kineze. Kjo do të thotë “të mësosh” dhe he do të thotë ‘mbledhje’. Fjala koreane do të thotë fjalë për fjalë “të mbledhesh për të mësuar”. Fjala për fenë, *xhong-kjo*, përbëhet nga dy shkronja kineze, që do të thonë përkatësisht “qendror” dhe “mësim”.

Kur fjala *kishë* do të thotë një mbledhje ku mësohen themelet shpirtërore, kjo ka një kuptim të mirë. Por domethënia e fjalës *kjohe* nuk siguron asnjë arsye që njerëzit të japin e marrin me njëri-tjetrin. Njerëzit, në përgjithësi nuk e përdorin fjalën *kjo-he* në atë kuptim.

Nuk doja ta fusnim veten në atë lloj kategorie separatiste. Shpresa ime ishte ngritja e një kisha pa një emërtim të veçantë. Feja e vërtetë përpiket të shpëtojë kombin, madje, edhe sikur t’i duhet të sakrifikojë trupin e vet për këtë gjë; përpiket të shpëtojë botën, duke sakrifikuar edhe kombin e saj; përpiket të shpëtojë njerëzimin, edhe sikur kjo të kërkojë sakrifikimin e botës. Në këtë kuptim, për asnjë çast një degëzim (fetar) nuk mund të marrë përparësi.

Ishte e nevojshme të varnim një tabelë kishe, por me zemër isha gati ta hiqja në çdo kohë. Sapo dikush var një tabelë ku thuhet *kishë*, ai është duke bërë një dallim midis kishtares dhe jokishtares. Të marrësh diçka, që është një, dhe ta ndash në dy nuk është e drejtë. Nuk ishte kjo ëndrra ime. Nuk është kjo rruga ku zgjodha të eci. Nëse më duhet ta heq atë shenjë për të shpëtuar kombin apo botën, jam gati ta bëj në çdo kohë.

Shenja jonë varej në hyrjen e përparme. Do të kishte qenë më mirë ta varnim diku më lart, por strehët e shtëpisë ishin shumë të ulëta, dhe nuk na mundësonin një vend të mirë për të varur një simbol. Në fund e varëm në lartësinë e një fëmije. Në fakt, disa fëmijë të lagjes e hoqën, luajtën me të dhe e ndanë më dysh. Për shkak të domethënies historike që kishte, ne nuk mund ta hidhnim. I bashkuam të dyja pjesët me tel dhe e mbërthyem më mirë përpara. Ndoshta, ngaqë simboli ynë u trajtua me përbuzje të atillë, edhe kisha jonë, gjithashtu, u trajtua poshtërsisht, përtej imagjinatës.

Strehët e çatisë ishin aq të ulëta, sa njerëzit duhet të ulnin kokën që të kalonin hyrjen. Dhoma ishte rreth 2,5 m² dhe aq e kufizuar, sa që kur luteshim gjashtë veta mund të përplasnim ballin me njëri-tjetrin. Banorët e lagjes qeshnin me simbolin tonë. Ata talleshin me ne duke na pyetur se ç’lloj unifikimi ëndërronim në atë shtëpi aq të vogël sa që “duhet të zvarritesh për të hyrë brenda”. Ata nuk përpiqeshin të kuptonin pse kishim zgjedhur atë emër. Thjesht na shikonin si të çmendur.

Sidoqoftë, kjo gjë nuk na shqetësonte. Në Busan kishim lypur ushqim për të jetuar, ndërsa tani kishim një dhomë ku bënim shërbesat. Nuk kishim frikë nga asgjë. Për kostum mora një palë rroba ushtarake amerikane dhe i ngjeva në ngjyrë të zezë. I vishja këto me këpucë gome të zeza. Megjithëse të tjerët të përpiqeshin të na ulnin vlerat, në zemër kishim më shumë dinjitet se kushdo.

Njerëzit që na ndiqnin e quanin njëri-tjetrin shik-ku ose anëtarë familje. Ishim të dehur nga dashuria. Gjithkush që vinte mund të shikonte çfarë bëja dhe të dëgjonte se çfarë thosha. Ne ishim të lidhur me një litar të padukshëm dashurie, që na lejonte të komunikonim me Zotin. Një grua mund të ishte në shtëpi duke përgatitur orizin dhe, befas, vinte me vrap në kishë. Dikush tjetër thoshte se do të shkonte të ndërronte fustanin dhe vinte me vrap në kishë, veshur me fustanin e vjetër vrima-vrima. Nëse njerëzit e burrit i qethnin flokët që ajo të mos shkonte në kishë, gruaja vinte me kokën tullë.

Me rritjen e numrit të anëtarëve, filluam të ungjillëzonim në komplekse universitare. Në vitet 1950, studentët e universiteteve shiheshin me respekt të veçantë nga shoqëria koreane si intelektualë. Ne nisëm të punonim pranë portës së universitetit të vajzave “Iuha” dhe universitetit “Jonsei”. Shpejt, një numër mjaft i madh studentësh po frekuentonin kishën tonë.

Profesori Jun Jong Jang, që jepte muzikë në “Iuha” dhe profesori Çung Hua Han, që ishte kujdestari i konviktit, erdhën në kishën tonë. Gjithashtu erdhën shumë studentë, por ata nuk vinin nga një e nga dy. Vinin dhjetëra, dhe numri i tyre u rrit në progresion gjeometrik. Kjo ishte një çudi për kishat zyrtare; për ne gjithashtu.

Brenda dy muajve, pasi filluam punën ungjillëzuese nëpër universitete, kongregacioni ynë shpërtheu nga numri i madh, kryesisht nga studentët e “Iuha”-s dhe “Jonsei”-t. Shpejtësia e rritjes ishte marramendëse. Dukej sikur kishte kaluar një fllad pranveror dhe kishte ndryshuar zemrat e studentëve, të gjitha përnjëherësh. Dhjetëra studentë të “Iuha”-s mblodhën plaçkat dhe dolën nga konvikti. Kjo ndodhi në një ditë të vetme. Nëse dikush mendohej t’i ndalonte i thoshin: “Pse? Pse po përpiqesh të më ndalosh? Nëse do të më ndalosh, duhet të më vrasësh. Më vrit!”. Madje, ata u larguan edhe duke kapërcyer muret që rrethonin godinën. Unë u

përpoqa t'i ndaloja, por ishte e kotë. Ata nuk donin të rrinin në shkollën e tyre të pastër; donin të rrinin në atë kishën tonë të vogël që kundërmonte erë këmbë. Askush nuk bënte dot gjë për ta ndryshuar këtë.

Më në fund, dekania Hual Ran Kim (Helen Kim) dërgoi në kishën tonë profesoren Jong Oon Kim, të departamentit të çështjeve sociale e fetare. Profesorja Kim kishte studiuar teologji në Kanada dhe ishte teologe, tek e cila "Iuha" mbante shpresa të mëdha për të ardhmen. Dekania Kim zgjodhi profesoren Kim, sepse specialiteti i saj ishte teologjia; ajo e mori si të mbaruar se do të zhvillonte një kritikë përfundimtare ndaj teologjisë sonë, gjë që mund të ndalonte përfundimisht fluksin e largimit të studenteve. Por, një javë pasi më takoi, kjo përfaqësuese speciale, profesorja Kim, u bashkua me kishën tonë dhe u bë një nga anëtarët më entuziaste. Kjo na dha edhe më shumë besueshmëri midis profesorëve dhe studenteve të tjera të "Iuha"-s. Numri i anëtarëve tanë rritej si orteuku.

Situata doli jashtë kontrollit, t dhe kishat zyrtare rifilluan të na akuzojnë se po vidhnim anëtarët e tyre. Kjo më dukej e padrejtë. Nuk i thashë kurrë askujt të dëgjonte fjalimet e mia apo të ndiqte kishën time. Nëse i përzija njerëzit nga dera kryesore, ata hynin nga dera e pasme. Nëse i kyçja dyert, kapërcenin nga gardhi. Isha i pafuqishëm për t'i ndalur. Më të hutuarit rreth kësaj situatë ishin administruesit e "Jonsei"-t dhe "Iuha"-s, që mbështeteshin nga fondacione të krishtera. Ata nuk mund të rrinin duarkryq, ndërkohë që studentët dhe trupa pedagogjike filluan të ikin mizëri tek një grup tjetër fetar.

Dy universitete përjashtojnë studentë dhe profesorë



Universiteti “Jonse” dhe universiteti i vajzave “Iuha” u futën në krizë, dhe në fund, morën një masë që nuk ishte përdorur kurrë më parë, dhe që nuk është përdorur kurrë më. “Iuha” pushoi nga puna pesë profesorë, duke përfshirë profesorin Jong On Kim dhe dëboi katërmëdhjetë studentë. Ndër studentët e dëbuar përfshiheshin edhe pesë, që ishin në vitin e fundit. Edhe “Jonsei” pushoi nga puna një profesor dhe dëboi dy studentë.

Pastori i “Iuha”-s u përpoq t’i këshillonte studentët duke u thënë: “Ju mund të shkoni në atë kishë pasi të mbaroni shkollën. Kështu, shkollës nuk do t’i vijë asnjë dëm”. Por kjo ishte e kotë. Pati efekt të kundërt.

Studentët e dëbuar protestuan me furi. “Ka shumë ateistë në shkollën tonë,- thoshin.- Madje në shkollën tonë, kemi edhe fëmijët e shamanëve tradicionalë. Si mund ta justifikojë shkolla dëbimin tonë dhe hipokrizinë e këtij standardi të dyfishtë?”

Megjithatë shkolla mbante qëndrim të njëjtë. Thjesht përsëriste pozitën e vet: “Ne jemi shkollë private dhe shkollë e krishtere. Kemi të drejtë të dëbojmë cilin student të duam”.

Kur media e mori vesh për incidentin, një gazetë shkroi një artikull kryesor: “Përjashtimi është i gabuar në një vend me liri fetare”. Situata

shpejt u bë temë debati për publikun e gjerë.

“Iuha”, meqë financohej nga një fondacion i krishterë në Kanada, ishte e shqetësuar se mos i ndërpritej financimi, nëse merrej vesh që një numër i madh i studentëve të saj ndiqnin një kishë, e cila ishte njohur si heretike. Në ato kohë, “Iuha” zhvillonte shërbesa fetare tri herë në javë, mbante shënim pjesëmarrjen dhe ia dërgonte këto të dhëna zyrave qendrore të misionit.

Pas përjashtimit të studentëve dhe pas pushimit të profesorëve, opinioni publik filloi të kthehet në favorin tonë. “Iuha”, në përpjekje për të kundërshtuar këtë prirje, filloi një fushatë shpifjesh mjaft të ulëta për t’u thënë. Fatkeqësisht, siç ndodh shpesh, sa më i ulët të jetë thashethemi, aq më shumë njerëzit argëtohen duke e besuar dhe duke e përsëritur atë si të ishte i vërtetë. Këto thashetheme të rreme filluan të ushqenin veten dhe, shpejt, morën një udhë pa krye. Kisha jonë vuajti nga kjo për më shumë se një vit.

Unë nuk doja që problemi të dilte jashtë kontrollit në atë mënyrë. Nuk doja të shkaktoja probleme. U përpoqa të bindja studentët dhe profesorët të bënin një jetë të thjeshtë e të qetë besimi. U shpjegova atyre se nuk ishte nevoja të largoheshin nga konviktet dhe të shkaktonin një trazirë të tillë publike. Por ata ishin të paepur. “Pse na thua të mos vijmë këtu?- pyesnin.- Ne kemi dëshirë të marrim të njëjtën hirësi si të tjerët”. Në fund ata u detyruan ta linin shkollën. Kjo gjë nuk më pëlqeu.

Pasi u dëbuan me forcë nga shkollat e tyre, studentët shkuan si grup në një vend lutjeje në malin Samgak, në periferi të Seulit. Shkuan atje për të ngushëlluar zemrat e tyre të plagosura. Ata ishin dëbuar nga shkolla, familjet ishin mjaft të inatosura dhe shokët nuk dëshironin t’i takonin më. Nuk kishin ku të shkonin. Agjëronin dhe shpenzonin gjithë kohën duke u lutur me emocione aq të forta, sa sytë u mbusheshin me lot dhe hun-

dët u rridhnin. Shumë shpejt disa filluan të flasin në gjuhë të panjohura. Është e vërtetë që Zoti shfaqet kur ne jemi në buzë të dëshpërimit dhe të pashpresë. Studentët e dëbuar nga shkollat e tyre të flakur në rrugë nga familjet dhe shoqëria, e gjetën Zotin në atë vend lutje në malin Samgak. Shkova në malin Samgak, u dhashë ushqim dhe zemër studentëve të dobësuar nga agjërimi.

“Boll po vuani që jeni përjashtuar padrejtësisht,- u shpjegova.- Ju lutem, mos bëni edhe agjërime. Nëse e keni ndërgjegjen e pastër për atë që keni bërë, atëherë nuk është e turpshme të fyheni nga kjo. Mos u shkrajoni, por prisni derisa të vijë koha juaj.”

Pesë nga studentët në vitin e fundit, më vonë, u transferuan në universitetin e vajzave “Suk-Mjung”. Por tashmë dëmi ishte bërë.

Ky incident luajti një rol vendimtar në formësimin e një reputacioni tërësisht negativ për mua. Raportimet e gazetave filluan të shkruanin sikur të gjitha veprat e këqija, të bëra nga lloj-lloj fesh, të ishin bërë nga ne. Njerëz që, në fillim reagonin ndaj thashethemeve me shprehjen “A të jetë e vërtetë vallë?”, tani filluan të thonë: “Është e vërtetë”.

Është e dhimbshme të trajtohesh kaq padrejtësisht. Padrejtësia ishte kaq e thellë, sa më irritonte. Doja të kundërshtoja me të madhe, por nuk fola dhe as nuk u përpoqa të luftoj. Kishim shumë gjëra të tjera për të përmbushur dhe nuk kishim kohë për të humbur me grindje.

Besoja, se një keqkuptim dhe një urrejtje e tillë do të tretej me kohën, dhe se ne nuk duhet t'i përdornim energjitë për t'u shqetësuar tej mase për to. Bëja sikur nuk i dëgjoja njerëzit kur thoshin: “San Mjang Mun-it duhet t'i bjerë rrufeja” apo, kur misionarët e krishterë luteshin për vdekjen time.

Por, në vend që të shuheshin, thashethemet shtoheshin edhe më fyese me kalimin e ditëve. Ndihesha sikur e gjithë bota ishte bashkuar për të më treguar me gisht dhe për të më akuzuar. Unë nuk i lejova të tjerët të më

shihnin kërcinjte edhe në kulmin e vapës, në fabrikën e plehut në Hungnam, por tani kishin dalë thashetheme se kërcëja lakuriq në kishë. Shumë shpejt, njerëzit, që vinin në kishën tonë për herë të parë, më shikonin me ca sy që dukeshin sikur thoshin: “Ti je ai që heq rrobat dhe kërcen?”.

E dija, më mirë se çdokush tjetër, se do të duhej kohë të zhdukeshin këto keqkuptime, kështu që asnjëherë nuk u përpoqa të bëja debat me ta, duke thënë se “nuk jam ashtu”. Ne nuk mund ta njohim dikë pa e takuar, megjithatë kishte shumë nga ata që nuk hezitonin të më mallkonin, madje, pa më takuar asnjëherë në jetën e tyre. E dija që ishte e kotë të kapeshe me njerëz të tillë, kështu që durova në heshtje.

Incidenti Jonsei-Iuha e detyroi kishën tonë të shkonte në prag të shkatërrimit. Imazhi i “pseudo-religjionit” ose i “kultit” u identifikua pazgjidhshmërisht me emrin tim, dhe të gjitha kishat zyrtare u bashkuan duke i bërë thirrje qeverisë të më përndiqte.

Më 4 korrik 1955, policia kontrolloi kishën tonë dhe më mori në arrest mua dhe katër anëtarë: Uon Pil Kim, Hjun Jong Ju, Hjo Min Ju dhe Hjo Uon Ju. Ministrat dhe kryepleqtë e kishave zyrtare u bashkuan me autoritetet shekullare, duke shkruar letra që bënë thirrje për mbylljen e kishës sonë. Katër anëtarët, të cilët kishin qenë me mua që në fillim, u detyruan të rrinë në burg me mua.

Çështja nuk mbaroi këtu. Policia hetoi të kaluarën time dhe doli me akuzën e shmangies së shërbimit ushtarak. Por edhe kjo ishte skandaloze. Në kohën kur u arratisa nga kampi i vdekjes së Koresë së Veriut për në jug, tashmë, e kisha kaluar moshën e shërbimit ushtarak të detyruar. Prapëseprapë më akuzuan për shmangie të shërbimit ushtarak.

Sythe të reja çelin mbi degët e djegura



Hetuesit e zyrës së inteligjencës speciale të Drejtorisë së Rendit Publik, që kishin kontrolluar kishën tonë dhe që më kishin marrë në arrest, më shpunë në stacionin e policisë në Çung Bu. U ofendova kur më akuzuan për shmangie të shërbimit ushtarak, por nuk thashë asgjë. E kisha gojën për të folur, por nuk m'u dha shansi kurrë të them as edhe një fjalë. Kur shikonin heshtjen time përballë trajtimeve të padrejta, disa më quanin të dobët. I duroja edhe këto nofka në heshtje, duke besuar që, edhe kjo, duhet të jetë gjithashtu një rrugë e cila më është dhënë dhe të cilën duhet ta shkel. Nëse kjo është rruga që duhet të ndjek për të arritur qëllimin tim, atëherë nuk kisha se çfarë të bëja. Ngaqë ndoqa një rrugë kaq të qartë, nuk më mposhtën dot. Sa më shumë që sulmohesha, aq më i kujdesshëm isha të veproja më ndershmërisht se çdokush tjetër.

Sa herë merrja këtë vendim në zemër, policia nuk më dominonte dot. Kur hetuesi po shkruante raportin e tij, e mësoja si ta shkruante. “Pse nuk shton edhe këtë gjë,- i thosha.- Dhe këtu lart, duhet të shkruash këtë”.

Ai bëri siç i thashë. Çdo frazë, që i thosha të shkruante, ishte e saktë, por kur hetuesi i vuri ato së bashku, zbuloi se ato e çuan në përfundimin e kundërt me atë që kishte ndërmend. Ai u inatos dhe e grisi raportin.

Në 13 korrik 1955, në ditën e gjashtë të arrestimit tim në rajonin e

policisë në Çung Bu, më futën në burg përsëri. Këtë radhë isha në burgun Sodemun, në Seul. Më vunë prangat, por nuk isha as i turpëruar dhe as i pikëlluar. Jeta në burg nuk ishte një pengesë për mua. Mund të shërbente si një motiv për të stimuluar një zemër të tërbuar, por nuk ishte kurrë një pengesë në rrugën time. Për mua ishte një mënyrë për të mbledhur kapital shtesë për veprimtaritë e mia të ardhshme. E kapërceva jetën e burgut duke i thënë vetes: “Nuk jam dikush që vdes në burg. Nuk është e mundur të vdes. Kjo është vetëm një trampolinë nga ku mund të bëj një kërcim të madh drejt botës së lirisë”.

Është rregulli i botës dhe ligji i qiellit, se ai që është i keq do të bjerë, dhe ai që është i mirë do të lartësohet. Edhe sikur të më duhet të shkoj në një grumbull me bajga, nuk do të dështoj, nëse mbaj një zemër të pastër. Ndërsa po më merrnin të prangosur, disa gra që kaluan afër, më panë shtrembër dhe rrudhën fytyrën në shenjë mospëlqimi. Prej tyre buronte ndjenja se isha i çuditshëm edhe në pamje, sepse ato besonin që isha udhëheqës i një kulti seksual. Por unë nuk kisha as frikë, as turp. Edhe kur përdroreshin fjalë të ndyra për të më sulmuar mua dhe kishën tonë, unë nuk do të lëkundesha.

Natyrisht, kisha ndjenja normale. Së jashtmi ruajta dinjitetin tim, por kishte shumë raste kur ndihesha si i mbytur dhe i brengosur deri në palcë. Sa herë më dobësohej zemra, duroja duke i thënë vetes: “Nuk jam dikush që thjesht mund të vdesë në burg. Do të ngrihem përsëri. Jam i sigurt për këtë”. E dyfishoja vendosmërinë duke thënë: “Po e marr të gjithë dhimbjen mbi vete. Jam duke mbartur të gjithë barrën e kishës sonë”.

Mund të pritej kollaj që burgimi im të nënkuptonte fundin e kishës sonë, me largimin e anëtarëve në punë të tyre. Përkundrazi, anëtarët vinin çdo ditë për të më vizituar në burg. Madje, në disa raste ziheshin se kush do të hynte i pari. Vizitat lejoheshin vetëm pas orës 8 të darkës,

por anëtarët zinin radhën dhe prisnin përtej portës së burgut që herët në mëngjes. Sa më shumë më mallkonin njerëzit, dhe sa më e vetmuar bëhej situata ime, aq më shumë njerëz mbanin radhë për të më vizituar, për të më inkurajuar dhe për të derdhur lot për mua.

Unë, as nuk i përshëndesja me emocione të forta. Në fakt, i refuzoja, duke u thënë gjëra të tilla si: “Pse vini dhe bëni kaq bujë?”. Prapë ata më ndiqnin me lot në sy. Kështu shprehnin besimin dhe dashurinë e tyre. Ishin të lidhur pas meje jo sepse dija të flisja qartë dhe rrjedhshëm. Më pëlqenin, sepse e njihnin dashurinë që kisha thellë në zemër. Anëtarët tanë e njihnin zemrën time të vërtetë. Edhe sikur të vdisja, nuk do të isha në gjendje t’i harroja kurrë anëtarët që më ndoqën, madje, edhe kur isha i detyruar të qëndroja i prangosur në burg. Gjithmonë e mbaj mend shprehjen e fytyrës së tyre, kur qanin me dënësë, ndërsa më shikonin në bankën e të akuzuarve.

Rojet e burgut habiteshin. “Si i bën ky njeri këta njerëz të çmenden pas tij?”, pyesnin veten, kur shikonin anëtarët tanë që grumbulloheshin tek burgu. “Ai nuk është burri i tyre dhe ato nuk janë gratë e tij. Nuk e kanë as djalë. Si mund të jenë kaq të devotshëm ndaj tij?”

Në një rast, që nuk ishte i vetmi, një roje komentoi: “Kemi dëgjuar se Mun është një diktator, shfrytëzues i njerëzve, por është më se e qartë se kjo nuk është fare e vërtetë”. Ky roje u bë anëtar dhe ndoqi rrugën tonë.

Më në fund, pas tre muajve në pranga, trupi gjykues më nxori të pafajshëm, dhe unë u lirova. Në ditën e lirimit, kryegardiani dhe gjithë shefat e burgut organizuan një përshëndetje zyrtare. Brenda tre muajve, të gjithë ata u bënë anëtarë të familjes sonë të unifikimit. Arsyeja pse zemrat e tyre u kthyen nga unë ishte e thjeshtë. Sapo më panë nga afër, e kuptuan që nuk isha, aspak, personi i paraqitur nga thashethemet që kishin dëgjuar. Me këtë ndryshim, thashethemet e rreme që qarkullonin

në shoqëri, në fakt, ndihmuan përpjekjet tona ungjillëzuese.

Kur u arrestova nga policia, gjithë media dhe shoqëria bëri bujë të madhe, por kur dola i pafajshëm dhe u lirova, ata heshtën. I vetmi raportim për vendimin e pafajshmërisë sime, dhe për lirimin tim, ishte një histori me tre rreshta në një qoshe që nuk ta zë syri, në një gazetë, ku thuhej: “Reverend Mun i pafajshëm, lirohet”. Thashethemet e ulëta, që kishin futur gjithë vendin në potere, kishin qenë të rreme, por ky informacion ishte varrosur plotësisht. Anëtarët tanë protestuan duke thënë: “Reverend Mun, kjo është e padrejtë. Kjo na indinjon aq shumë, saqë nuk mund të durojmë”. Ata qanin para syve të mi, por unë heshtja dhe i qetësoja.

Nuk e harroj dot kurrë dhimbjen që përjetoja kur sulmohesha dhe provoja gjithë ato akuzime të pavërteta. Durova, edhe kur u ngritën kundër meje aq shumë njerëz, sa ndjehesha se nuk kishte mbetur asnjë centimetër vend në gjithë Korenë ku mund të qëndroja. Brenga që kam ndjerë në atë kohë ka mbetur tek unë, në një cep të zemrës time.

Mund të jem një pemë e goditur nga era dhe shiu, dhe e përcëlluar nga zjarri, por nuk do të jem kurrë një pemë që digjet dhe thahet. Madje, edhe një degë e përcëlluar do të nxjerrë sytha të rinj kur të vijë pranvera. Nëse vazhdoj rrugën time me përulësi dhe bindje të thellë, do të vijë me siguri një ditë, kur bota do të kuptojë vlerën e asaj që unë bëj.

Ne stërvitemi prej plagëve tona



Njerëzit refuzuan shprehjen e re të së vërtetës që predikova, duke e quajtur atë herezi. Jezusi, i lindur në tokën e judaizmit, në të njëjtën mënyrë u akuzua për herezi dhe, prandaj, u kryqëzua. Në krahasim me të, persekutimi im nuk ishte aspak aq i dhembshëm dhe aq i padrejtë. Munda të duroj çfarëdo dhimbje mbi trupin tim. Por akuza e herezisë ndaj kishës sonë ishte më e padrejta dhe më e vështira për mua.

Disa teologë, që kanë studiuar kishën tonë në fillimet e saj, i kanë përshkruar mësimet tona si origjinale dhe sistematike. Disa ishin të përgatitur t'i pranonin. Kjo do të thotë, se gjerësia e debatit në lidhje me herezinë, që rrethonte kishën tonë, kishte të bënte më shumë sesa, thjesht, me teologjinë. Kjo kishte të bënte më shumë me çështje pushteti.

Shumica e anëtarëve tanë kishin ndjekur kisha të tjera, para se të bashkoheshin me kishën tonë. Kjo ishte një arsye e fortë pse kisha jonë konsiderohej si një armike nga kishat zyrtare. Kur Jun Jong Jang, një nga profesorët e “Iuha”-s, iu bashkua kishës sonë, ajo u thirr për tu marrë në pyetje në rajonin e policisë. Atje zbuloi, se rreth tetëdhjetë ministra të krishterë i kishin shkruar letra autoriteteve, duke kritikuar kishën tonë. Ishte e qartë, nuk ishte se kishim bërë diçka të gabuar. Më tepër ne paraqitnim kërcënim ndaj pushtetit të disa njerëzve apo institucioneve të

caktuara. Ishin ndjenjat e tyre të turbullta të frikës dhe të fraksionizmit ekstrem, që i shtynë drejt përpjekjeve për të shtypur kishën tonë.

Njerëz nga shumë grupe fetare tërhiqeshin nga kisha jonë dhe nga mësimet e saj të reja. U thosha anëtarëve të rinj: “Pse keni ardhur këtu? Kthehuni në kishat tuaja”, dhe pothuajse i kërcënoja duke u përpjekur t’i largoja. Por ata ktheheshin përsëri. Njerëzit, që grumbulloheshin të më shikonin mua, nuk dëgjonin asnjë tjetër. Nuk dëgjonin as mësuesit dhe as prindërit e tyre. Donin të më dëgjonin kur flisja. Unë as nuk i paguaja dhe as nuk u jepja për të ngrënë, por besonin në mësimet e mia dhe vazhdonin të vinin. Arsyeja pse vinin ishte, se u kisha hapur rrugën për të zgjidhur zhgënjimet e tyre. Para se të dija të vërtetën edhe unë isha i mërëzitur. Isha i indinjuar kur shikoja lart, në qiell, dhe kur shikoja njerëzit rreth meje. Ja, pse mund të kuptoja irritimin e njerëzve që vinin në kishën tonë. Ata kishin pyetje për jetën, dhe nuk gjenin dot përgjigje për to. Fjala e Zotit, që unë transmetoja, u jepte përgjigje të gjitha pyetjeve qartësisht. Të rinjtë, që më kërkonin, gjetën përgjigje në fjalët që u flisja. Donin të vinin në kishën tonë dhe të bashkoheshin me mua në udhëtimin tim shpirtëror, sado e vështirë të ishte.

Unë jam personi që e gjen rrugën dhe e hap atë. I udhëzoj njerëzit që, gjatë rrugës, të shërojnë familjet e shkatërruara dhe të rindërtojnë shoqërinë, kombin dhe botën, në mënyrë që, më në fund, të kthehen tek Zoti. Njerëzit që vijnë te unë e kuptojnë këtë. Ata duan të vijnë me mua në kërkim të Zotit. Si mund ta quajnë njerëzit të gabuar këtë gjë? Gjithë çka ishim duke bërë ishte se po kërkonim Zotin. Dhe për këtë iu nënshtruan lloj-lloj persekutimesh dhe kritike.

Fatkeqësisht, gjatë kohës që kisha jonë ishte përfshirë në polemikën e herezisë, gruaja ime m’i vështirësoi më shumë gjërat. Pas takimit tonë në Busan, ajo dhe të afërmit e saj filluan të kërkonin që, ose të lija kishën


menjëherë dhe të filloja jetën me të dhe me djalin tonë, ose ndryshe t'i jepja divorcin. Madje, ata erdhën në burgun Sodemun, gjatë burgosjes sime atje, dhe më vunë përpara letrat e divorcit, duke më kërkuar të vija firmën. Unë e di sa e rëndësishme është martesë në përpjekjet për të krijuar një botë paqësore të Zotit, kështu që durova kërkesat e tyre në heshtje.

Ajo, gjithashtu, abuzoi tmerrësisht ndaj anëtarëve të kishës sonë. Personalisht munda të duroj. Nuk doja t'ia dija nga fyerjet apo veprimet e saj të pamatura kundrejt meje, por ishte e vështirë të rrija dhe të shikoja sjelljen e saj ofenduese ndaj anëtarëve tanë. Ajo vinte si stuhi në kishë, në çdo kohë, për të mallkuar anëtarët, shkatërronte pasurinë e kishës dhe merrte gjëra që i përkisnin kishës. Madje, ajo hidhte ujëra të zeza mbi anëtarët. Kur vinte ajo, ishte e pamundur të zhvillonim shërbesat e adhurimit. Në fund, sapo dola nga burgu Sodemun, pranova kërkesën e familjes së saj dhe vura firmën në dokumentin e divorcit. U detyrova të divorcohesha kundër parimeve të mia.

Tani, kur mendoj për gruan e parë, zemra më shkon tek ajo. Ndikimi i familjes, e cila ishte e krishtere e fortë, dhe kryesia e kishave zyrtare të Koresë pati shumë lidhje me sjelljen e saj të atëhershme. Ajo ishte kaq e qartë dhe e vendosur në angazhimin e saj para se të martoheshim. Mënyra si ndryshoi na mëson se sa shumë duhet t'i druhemi fuqisë së paragjykimëve sociale dhe koncepteve ekzistuese.

Përjetova edhe brengën e divorcit, edhe dhimbjen e damkosjes si here-tik. Por nuk u përkula. Këto ishin gjëra që duhet t'i duroja në rrugën time për të shpëguar mëkatin origjinal të njerëzimit, gjërat që duhet të duroja për të ecur përpara në rrugën drejt Mbretërisë së Zotit. Është errësirë e madhe para agimit. E kapërceva errësirën duke iu qepur Zotit dhe duke iu lutur Atij. Përveç çasteve të shkurtra, që kaloja në gjumë, gjithë kohën tjetër e shpenzoja në lutje.

Më e rëndësishmja nga të gjitha është zemra e singertë



Urishfaqe në botë pas tre muajsh, pasi u shpalla i pafajshëm. Atëherë kuptova, më shumë se kurrë, se i kisha një borxh shumë të madh Zotit. Për të paguar këtë borxh, kërkova dhe gjeta një vend ku kisha jonë mund t'ia fillonte nga e para. Megjithatë nuk lutesha duke thënë: “Zot na ndërto një kishë”. Nuk u ankova kurrë dhe as më vinte turp nga ajo ndërtesë e vogël dhe e përlurur, që përdornim si kishë deri në atë kohë. Isha mirënjohës që kisha një vend ku të lutesha. Nuk uroja kurrë të kisha një vend më të madh, apo më të rehatshëm.

Prapëseprapë, ne kishim nevojë për një vend ku anëtarët tanë të mblidheshin dhe të ofronin shërbesat, kështu që morëm një kredi prej dy milionë uon dhe blemë një shtëpi në gjendje të keqe, buzë një kodre në Çongpa Dong. Ajo ishte një nga shumë shtëpitë e kategorizuara si “pasuri e armikut”, që do të thoshte se kishin qenë bosh qëkur ishin braktisur nga japonezët, që u larguan nga Koreja në kohën e çlirimit. Ishte një shtëpi e vogël, vetëm me një sipërfaqe prej 65 metra katror. Ishte në fund të një rrugice të gjatë dhe të ngushtë. Kur i afroheshe shtëpisë, dukej sikur ecje përmes një tuneli të gjatë dhe të errët. Të gjitha kolonat dhe muret i kishte mbuluar pislëku, gjë që na bëri të pyesim veten, se çfarë do të ketë pasur atje para se të rrinim ne. Punova bashkë me të rinjtë e kishës sonë katër

ditë rresht për të kruar gjithë pisllekun me solucion sodik.

Pas zhvendosjes në kishën në Çongpa Dong, pothuajse nuk flija fare. Ulesha në dyshemenë e dhomës kryesore i mbledhur shuk, duke u lutur deri në orën tre ose katër të mëngjesit. Mund të dremisja deri në orën pesë, por pastaj do të ngrihesha dhe do të filloja veprimtaritë e ditës. E vazhdova këtë stil jete për shtatë vite rresht. Megjithëse bëja vetëm një ose dy orë gjumë në ditë, nuk ndjehesha kurrë i përgjumur gjatë ditës. Sytë më ndriçonin si ylli i mëngjesit. Kurrë nuk ndjehesha i lodhur.

Kisha aq shumë gjëra në mendje, sa madje, nuk doja as të humbja kohë duke ngrënë. Në vend që t'i bëja njerëzit të shtronin tavolinën për vaktet e mia, haja në dysheme duke i mbledhur këmbët kryq për të ngrënë. “Shprehe dedikimin. Lëre atë të vërshojë edhe sikur të jesh përgjumësh! Dedikohu deri sa të jesh i rraskapitur!”, vazhdoja t'i përsërisja këto fjalë me vete. U luta në mes të kundërshtimeve të vazhdueshme dhe akuzimeve të pavërteta, me mendimin se isha duke mbjellë fara që një ditë do të jepnin një prodhim të bollshëm. Nëse të korrat nuk do të kishin mundësi të vileshtin në Kore, atëherë isha i bindur se do të vileshtin në ndonjë vend tjetër të botës.

Një vit pas lirit nga burgu, kisha jonë kishte katërqind anëtarë. Kur lutesha, i përmendja emrat e tyre një nga një. Fytyrat e tyre më përshkonin mendjen, edhe para se të përmendja emrat e tyre. Disa do të ishin duke qarë, disa duke qeshur. Në lutjet e mia, isha në gjendje të thosha se në çgjendje ishte secili në atë çast, përfshirë edhe rastet kur ishin duke vuajtur nga ndonjë sëmundje.

Nganjëherë, ndërsa thërrisja emrat e tyre në lutje, merrja frymëzimin që më thoshte se një person i caktuar do të vinte në kishë atë ditë. Ai person do të vinte patjetër. Kur i afrohesha ndonjërit që më ishte shfaqur i sëmurë në lutje dhe e pyesja: “A je sëmurë?”, personi e pohonte. Anëtarët

habiteshin shumë që e dija kur ishin të sëmurë, pa më thënë njeri. Çdo herë më pyesnin: “Nga e di ti këtë?”. Unë u përgjigjesha vetëm me një buzëqeshje.

Diçka e tillë ndodhi kur ishim duke u përgatitur për Ceremoninë e Bekimit të Shenjtë. Para ceremonisë, i pyeta të gjithë kandidatët, vajza dhe djem, nëse kishin mbajtur virgjërinë apo jo. Kur pyeta njërin prej kandidatëve, ai u përgjigj më një zë të lartë se kishte qëndruar i virgjër. E pyeta për herë të dytë dhe, përsëri, ai më siguroi që ishte i pastër. E pyeta për herë të tretë, dhe ai më dha, përsëri, të njëjtën përgjigje. E pashë drejt e në sy dhe i thashë: “Ti e ke bërë ushtrinë në Huaçon, në Provincën e Kanguonit, apo jo?”. Këtë herë ai u përgjigj “po” me një zë të trembur.

“Ti more lejen, dhe rrugës, duke ardhur për në Seul qëndrove në një bujtinë, apo jo? Dhe pikërisht atë natë ti pate marrëdhënie të jashtëligjshme me një vajzë, që kishte veshur fund të kuq. E di fare mirë çfarë ke bërë. Pse gënjen?”

U inatosa me atë burrë dhe e dëbova nga Ceremonia e Bekimit. Nëse njeriu i mban hapur sytë e tij të zemrës, ai është në gjendje të shikojë edhe atë që fshihet.

Disa tërhiqeshin nga kisha jonë, më shumë për shkak të këtyre dukurive paranormale, sesa nga mësimet e saj. Shumë njerëz mendojnë se fuqitë shpirtërore janë më të rëndësishme. Sidoqoftë, dukuritë e quajtura shpesh si mrekulli priren t'i ngatërrojnë më keq njerëzit në shoqëri e më gjerë. Një besim që bazohet në ndodhi të pashpjegueshme ose të mrekullueshme, nuk është besim i shëndetshëm. Gjithë mëkati duhet të restaurohet nëpërmjet zhdëmtimit. Kjo nuk mund të bëhet duke u varur në fuqitë shpirtërore. Me rritjen dhe maturimin e kishës sonë, ndalova së treguari anëtarëve rreth gjërave që shikoja me sytë e zemrës.

Numri i anëtarëve vazhdoi të rritet. Nëse takoja qindra njerëz, veproja

njësoj, sikur të ishte vetëm një. E dëgjoja sa herë që një person dëshironte të më tregonte situatën e vet personale. I moshuar apo i ri, e dëgjoja me dedikim, sikur të ishte i vetmi person me të cilin më duhej të merresha. Çdo anëtar do të thoshte: “Asnjëri në Kore nuk dëgjon atë që dua t’i them aq mirë, sa Reverend Mun”. Një gjyshe niste të më tregonte si ishte martuar dhe përfundimisht më tregonte sëmundjen e të shoqit.

Më pëlqente të dëgjoja të tjerët kur më flisnin për veten. Kur njerëzit më hapeshin dhe më tregonin, nuk e kuptoja fare se si ikte koha. I dëgjoj për dhjetë apo njëzet orë madje. Njerëzit që duan të flasin kanë një ndjenjë urgjence. Ata kërkojnë zgjidhje për problemet e tyre. Kështu që e ndiej që duhet t’i dëgjoj me përkushtimin tim të plotë. Kështu mund t’i doja ata dhe mund të paguaja borxhin që i kisha (Zotit) për jetën time. Gjëja më e rëndësishme është të mendosh se jeta është e çmuar. Ashtu siç dëgjoja me sinqeritet atë që thoshin të tjerët, gjithashtu ndaja me ta zemrën time të sinqertë me zjarr dhe lutesha për ta me lot.

Sa shpesh jam lutur me lot për gjithë natën? Lotët e njomnin parketin e dyshemesë kur lutesha deri në atë pikë, saqë ishte e pamundur të thahej.

Më vonë, kur isha në Shtetet e Bashkuara, më erdhi fjala që anëtarët e kishës po planifikonin të rregullonin kishën Çongpa Dong. U dërgova një telegram urgjent ku i thosha të ndalonin menjëherë punimet në kishë. Po, kjo kishë mishëron një periudhë të papërsëritshme në historinë time personale dhe, çështje më e rëndësishme, ajo dëshmon direkt për historinë e kishës sonë. Sado bukur të rinovohej, çfarë vlere do të kishte ajo, nëse historia jonë do të shkatërrohej? Ajo që ka rëndësi nuk është pamja e jashtme e bukur, por jeta e shenjtë e lotëve që jeton në atë ndërtesë. Ndoshta nuk përmbush disa standarde cilësie, por mishëron një traditë dhe pikërisht aty qëndron vlera e saj. Njerëzit që nuk janë në gjendje të respektojnë traditën e tyre janë të destinuar të dështojnë.

Ka një histori të gdhendur në kolonat e kishës së Çonpadong. Kur shikoj një kolonë të caktuar, më kujtohet koha kur jam kapur pas asaj shtyllë dhe kam qarë për një çështje të caktuar. Kur shikoj atë shtyllë, ku kam qarë më parë, më vjen të qaj përsëri. Kur shikoj një tra dere pak të përkulur, më kujtohet e shkuara. Mirëpo, tani dërrasat e vjetra të dyshemesë nuk janë më. Dërrasat e dyshemesë ku gjunjëzohesha në lutje dhe derdhja aq shumë lot kanë ikur; edhe gjurmët e atyre lotëve kanë ikur bashkë me to. Ajo për të cilën kam nevojë janë kujtimet e asaj dhimbjeje. Nuk ka rëndësi nëse stili, ose pamja e jashtme është e vjetër. Shumë kohë ka kaluar, dhe tani, ne kemi shumë kisha të ndërtuara mirë. Por mua, për vete, do të më pëlqente të shkoja në atë shtëpinë e vogël në kodrën e Çonpadogut dhe të lutesha atje. Ndihem më rehat atje.

E kam kaluar gjithë jetën duke u lutur dhe duke predikuar, por edhe tani dridhem kur qëndroj para një grupi njerëzish. Kjo ndodh, sepse të qëndrosh në një pozitë të tillë dhe të flasësh për çështje publike mund të thotë që shumë jetë do të shpëtohen, ose shumë do të humbasin. Për mua është një çështje me rëndësi jetike që të mund ti udhëheq njerëzit që dëgjojnë fjalët e mia drejt rrugës së jetës. Këto janë çastet kur heq një vizë të dukshme në udhëkryqin midis jetës dhe vdekjes.

Edhe tani, unë nuk i shkruaj paraprakisht kumtesat. Kam merak, se duke bërë këtë, mund të lejoj që objektivat e mia private të hyjnë në përmbajtje. Me një përgatitje të atillë mund të mburrem me dijet që kam grumbulluar në kokë, por nuk mund të shpreh zellin dhe pasionin e zemrës sime. Gjatë asaj kohe, para se të shfaqesha në publik, ofroja gjithmonë dedikimin tim, duke shpenzuar të paktën dhjetë orë në lutje. Kjo është mënyra si i ngula rrënjët e mia thellë e më thellë. Një pemë të fuqishme, edhe sikur gjethet t'i jenë ngrënë nga insektet, mbetet e shëndetshme nëse ka rrënjë të thella. Fjalët e mia mund të duken si pa vend nganjëherë, por

gjithçka do të jetë në rregull sa kohë të kenë brenda sinqeritetin e zemrës.

Në fillimet e kishës sonë vishja një xhaketë ushtarake amerikane dhe uniformë të ngjyer në të zezë dhe predikojta me një zjarr të tillë, sa bëhesha ujë nga djersa dhe lotët. Nuk kishte ditë që të mos qaja me të madhe. Zemra më mbushej me emocione dhe lotët më rridhnin vetiu nga sytë e nëpër faqe. Ato ishin kohë kur shpirti im dukej sikur ishte gati për ta lënë trupin. Ndihesha sikur isha në buzë të vdekjes. Rrobat i kisha ujë në djersë dhe bula djerse më binin nga koka.

Në kohën e kishës së Çonpadongut, të gjithë kaluan vështirësi, por Hjo Uon Ju duroi një vështirësi edhe më të madhe. Ai vuante nga një sëmundje në mushkëri dhe e kishte shumë të vështirë, por prapëseprapë ai dha leksione mbi mësimet e kishës sonë për tetëmbëdhjetë orë në ditë, për tre vjet e tetë muaj. Ne nuk kishim para për të ngrënë mirë. Hanim elb në vend të orizit dhe mbaheshim vetëm me dy vakte në ditë. Pjata shoqëruese ishte kimçi e pabërë mirë, që ishte lënë të fermentohej vetëm një natë.

Hjo Uon Ju pëlqente të hante karkaleca të vegjël, të kripur. Vendoste një enë me ato karkaleca të vegjël në cep të dhomës dhe, herë pas here, hante ca prej tyre me çopstik. Ja, kështu i kalonte ato ditë të vështira. Më dhimbte zemra kur shikoja Hjo Uon Junë që shtrihej i rraskapitur në dysheme; i uritur dhe i lodhur. Desha t'i blija kërmij të konservuar, por, në atë kohë, për ne ishin shumë të shtrenjta. Akoma më dhimbset kur mendoj sa shumë punonte, duke u përpjekur të shënonte fjalët që më rridhnin si ujëvarë, edhe pse ishte i sëmurë.

E ndihmuar nga puna e madhe dhe nga sakrifica e anëtarëve, kisha u rrit qëndrueshëm. Për nxënësit e shkollave të mesme dhe të lartë u formua Shoqata e Studentëve “Sunghua”. Ishin të frymëzuar kur merrnin me vete drekat, që kishin përgatitur nënat për ta, dhe ua jepnin misionarëve tanë

pionierë, që edhe ata të mund të hanin. Me iniciativën e tyre, nxënësit krijuan një listë që tregonte radhën e atyre që sillnin drekën e tyre për misionarët. Anëtarët që duhet ta hanin atë drekë, e dinin se ai student nuk do të kishte çfarë të hante atë ditë dhe do të ishte i uritur, kështu që hanin duke qarë. Shprehja e përkushtimit të studentëve ishte edhe më mbresëlënëse sesa thjesht dreka, kështu që të gjithë ne dyfishuam vendosmërinë për të përmbushur vullnetin e Zotit, edhe sikur të na duhej të sakrifikonim jetën tonë.

Megjithëse ishin kohë të vështira, dërguam misionarë në shumë vise të vendit. Pavarësisht nga dëshira e sinqertë e anëtarëve, ujëvara e thashethemeve të turpshme i bënte ta kishin të vështirë të shpreheshin hapur, se ishin nga Kisha e Unifikimit. Shkonin nëpër lagje, pastronin rrugët dhe ndihmonin shtëpitë që kishin nevojë. Mbrëmjeve misionarët tanë mësonin analfabetët dhe u tregonin njerëzve fjalën e Zotit. U shërbenin njerëzve në këtë mënyrë, për disa muaj, dhe fitonin besimin e tyre. Si rezultat, kisha jonë vazhdonte të rritej. Nuk i kam harruar anëtarët që, megjithëse kishin shumë dëshirë të shkonin në shkollë, në vend të kësaj zgjodhën të rrinë me mua dhe t'i dedikohen punës për kishën.

faqe bosh